



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
KULTURËS DHE TURIZMIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË
KULTURORE
Sektori i Trashëgimisë Kulturore

Elbasan, më 20.10. 2025

Propozim për shpallje “Monumente natyrore” kategoria e III e Mbrojtjes

Në kuadër të rivlerësimit të listës së Monumenteve të Natyrës, i realizuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, është kryer procesi i rishikimit dhe vlerësimit të çdo Monumenti të Natyrës i shpallur në Republikën e Shqipërisë me Vendimin nr. 303, datë 10.05.2019, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare", i ndryshuar. Rivlerësimi është realizuar në bazë të pikës 5 të nenit 17 të ligjit 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar dhe ka patur për qëllim të sigurojë përputhshmëri me parametrat e mbrojtjes së biodiversitetit dhe ruajtjen e vlerave natyrore, shkencore, estetike dhe kulturore.

Realizimi i rivlerësimit të monumenteve të natyrës është kryer mbi bazën e një metodologjie të integruar, që kombinon analizën hapësinore gjeografike, vlerësimin ekologjik, kriteret ligjore dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e elementeve natyrore me rëndësi të veçantë. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, gjatë procesit të rishikimit të Monumenteve të Natyrës, ka propozuar gjithashtu zgjerimin e listës ekzistuese.

Monumentet e propozuara për shtim, të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, plotësojnë një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

Vlera natyrore të spikatura: elemente unike të peizazhit, formacione gjeologjike, burime ujore, pyje monumentale apo habitate të rralla.

Vlera shkencore: zona që ofrojnë potencial të lartë për kërkime, studime dhe monitorim afatgjatë të biodiversitetit.

Vlera estetike: objekte që kontribuojnë ndjeshëm në identitetin vizual dhe turistik të rajonit.

Vlera kulturore: elemente natyrore të lidhura me tradita, legjenda apo histori vendore. Përzgjedhja u bë duke respektuar parimet e përfaqësimit gjeografik dhe ekologjik, në mënyrë që rrjeti i Monumenteve të Natyrës të mbulojë një spektër më të gjerë ekosistemesh dhe tipologjish natyrore.

Gjatë vlerësimit të monumente ekzistuese në Bashkinë Elbasanit nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura janë propozuar edhe:

Shpella e Mbytjes Krrabë e Vogël (Funar) 199.62 Elbasan
Lule Helmi Shqiptar (Guri i Zi) 6,315.89 Elbasan

për tu bërë pjesë në listën e "Monumenteve natyrore" kategoria e III e mbrojtjes.

Në bazë të nenit 10 të ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar, shpallja e zonave të mbrojtura mjedisore bëhet në përputhje me planin kombëtar të zonave të mbrojtura, pas marrjes së mendimit të institucioneve akademike e shkencore në vend, dhe të bashkisë brenda territorit administrativ të të cilës ndodhet zona.

Sipas pikës d dhe dh të nenit 12 të të njëjtit ligj, plani i shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe në bashkinë apo qarkun ku ndodhet zona që propozohet të shpallet.

Shpella Mbytjes Krrabë e Vogël (Funar)

Shpella Mbytjes ndodhet në vendin e quajtur Kalaja, në fshatin Mollagjesh të krahinës së Funarit, Elbasan. Shpella ka një hyrje të ngushtë në formë harku, me pjerrësi për poshtë. Në brendësi të saj është e mbushur me stalaktite stalagmite, kolona dhe silueta të përdredhura të shpërndara në dysHEME dhe në muret e saj në mënyrë të çrregullt. Shpella mbart një legjendë, ku disa krushq bashkë me nusen, që ishin futur për t'u strehuar, u kthyen në gur nga mallkimi i shpellës. Ende sot, si dëshmi e kësaj gojëdhane, brenda në shpellë ndodhen disa formacione shkëmbore të ngurtësuara, me pozicione të habitshme, të cilët, rrëfenja popullore e zonës i trajton si, "ata, krushqit e mbytur" të legjendës.







Lule Helmi shqiptar

Lule Helmi shqiptar (*Gymnospermum shqipetorum* Pap et Qos), është bima barishtore endemike në lartësinë 1170m mbi nivelin e detit., në krahun e djathtë të rrugës auto Elbasan - Kollogjesh mbi fshatin Guri i Zi.

